




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DP</u>	Nr Prot. Br. Prot. <u>01/3847/11</u>
Nr. I faq Broj stranica	Data Datum <u>11.10.2011</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

03.10.2011

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 45 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit nxjerr këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti me nr. protokolli: AKK – 03-3104 / 11, i trajtuar për konflikt interesi për zyrtaren, Z. Alma LAMA – Deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për Konflikt Interesi, me nr. protokolli AKK-03-3104/11, është vërtetuar se ka pasur prova të mjaftueshme që kanë argumentuar gjendjen e konflikti të interesit për zyrtaren e lartë, prandaj të lartpërmendures i është bërë shkresa e parë njoftuese me datën 04.07.2011 me të cilën ajo është njoftuar për ekzistimin e situatës konflikt interesi dhe njëkohësisht zyrtares i është mundësuar takimi me zyrtarët e Agjencisë për të sqaruar situatën dhe për tu njoftuar ajo me veprimet se cilat duhet t'i ndërmarr për ta shmangur situatën në të cilën është gjendur ajo.

Me datën 15.09.2011 me zyrтарen e lartë të përfshirë në këtë rast është mbajtur një takim që ndryshe quhet "ballafaqimi i fakteve" (neni 18 pika 3, Ligji nr.04/L-051) në të cilin ajo është njoftuar detalisht pse ndodhet në situatë konflikt interesi dhe po ashtu është njoftuar me afatet ligjore, dhe me procedurat që duhet t'i ndjek për të shmangur këtë situatë të konflikti të interesit.

Me datën 15.09.2011 zyrтарja e lartë, Z.Lama, ka njoftuar se është e gatshme të sjell provat me të cilat do të dëshmoj se ka bërë shmangien e situatës konflikt interesi në të cilën ajo ndodhej deri atëherë. Në të njejtën ditë në takimin e mbajtur mes zyrтарit të Agjencisë kundër korrupsionit dhe zyrтарës së lartë të përfshirë në këtë rast janë pranuar dëshmitë konkrete të dokumentacionit zyrтар të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bisneseve në Kosovë, në të cilin shihet se Z.Alma Lama, ashtu siç është kërkuar nga ajo, konform nenit 14. pika 1 të Ligjit për Parandalimin e Konflikti të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ka bërë bartjen e të drejtave në drejtimin e ndërmarrjes në një person tjetër (të besuar).

Prandaj ***në bazë të Ligjit Nr.04/L-051***, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ***neni 18, pika 12***, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) nxjerr këtë vendim me të cilin vendoset si në dispozitiv.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit të DP-së
- Zyrтарit përgjegjës në AKK
- Zyrtares Alma Lama

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Prteni /

